


Fshehtësitë e agjërimit



16

Imam Gazaliu

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

FSHEHTËSITË E AGJËRIMIT

Imam Gazali

Prishtinë 2017

Titulli i origjinalit

Ihjaul Ulumid-din

(Ringjallja e diturive fetare)

Kitâbu esrâri's-savm

Imam Gazali

Përgatiti dhe përktheu:

Shenaj Zeneli

Lektor:

Artan Sadiku

Përgatitja kompjuterike:

Abdullah B. Ferizi

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE..... 5

**FARZET (KUSHTET), SUNNETET DHE
OBLIGIMET NË RAST TË PRISHJES SË
AGJËRIMIT..... 14**

KUSHTET E JASHTME TË AGJËRIMIT15

SUNNETET E AGJËRIMIT.....26

**FSHEHTËSITË E AGJËRIMIT DHE KUSHTET E
BRENDSHME..... 31**

**AGJËRIMET VULLNETARE (NAFILE) DHE
RENDITJA E TYRE 49**

Me emër të Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëplotit!

PARATHËNIE

Falënderimi (hamd) i takon vetëm Allahut, Ai Allah që ngushëllon dhe lartëson robin e Tij, duke e mbrojtur atë nga komplotet dhe dëshirat e shejtanit, duke ia shuar atij të gjitha shpresat dhe duke ia prishur të gjitha planet. Ti falendërohemi Atij që agjërimin e bëri kalá dhe mburojë të miqve të Tij (evlijave). Miqve të Tij u hapi dyert e Xhennetit, dhe i njoftoi ata se epshet (shehvet¹) e fshehta janë mënyra e shejtanit për të hyrë në zemër, me injorimin e këtyre epsheve dhe forcimin e shpirtërave të tyre të qetë ‘nefsu’i-mutmainne’ arrihet tek mposhtja e armikut - shejtanit.

I dërgojmë selame Muhammedit s.a.v.s. – të zgjedhurit në krye të të gjithëve, duke u bërë udhërrëfyes i njerëzve, ua lehtësoi këtë rrugë. Familjes së tij (Ehli-bejt), dhe shokëve të tij, mendjeprehtë dhe të kthjellët. Le të jetë shpëtimi mbi gjithë ata.

¹ **Shehvet:** epshi; kërkesa për ngrënie, pirje, veshje, shikim, dëgjim, të folur, seks, etj.

Dije se: agjërimi është çereku i besimit (imanit), që konstatohet në bazë të fjalëve të Muhammedit, a.s.,:

“Agjërimi është gjysma e durimit (sabir).”²

“Durimi është gjysma e besimit.”³

Gjithashtu, agjërimi është një ibadet që bëhet posaçërisht vetëm për Allahun. Kështu thotë Allahu Teala me një hadith kudsij, që na transmeton Resulallahu a.s.:

“Për çdo veprim të vlefshëm shkruhen dhjetëra të tilla e deri në shtatëqind herë më shumë, vetëm agjërimi është posaçërisht për Mua, dhe Unë për atë shpërblejë.”⁴

Allahu Teala thotë:

“Vetëm ata që janë të durueshëm, do të shpërblehen pamasë”. 39-Zumer: 10

² Tirmidhiu nga Benu Selimi. Hadithin e shënon edhe Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre

³ Ebu Nuajm në *‘Hilje’*

⁴ Buhari dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

Agjërimi është gjysma e durimit. Është e pamundur të vlerësohet dhe llogaritet shpërblimi i tij. Mbi vlerën e tij është e mjaftueshme për ne të përmenden fjalët e Resulallahut, s.a.v.s.:

- Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, era që vjen nga goja e agjëruetit është më e mirë dhe më e dashur tek Allahu sesa era e miskut. Allahu Teala thotë:

- ‘E lë pasionin e tij, ushqimin e tij, dhe pijen e tij për hatër Tim. E pra agjërimi është për Mua, dhe Unë për atë shpërblejë’.⁵

Resulallahu s.a.v.s.,thotë:

"Është një derë në Xhennet që quhet ‘Rejjan’, nga e cila do të hyjnë vetëm agjëruetit.”⁶

Agjëruetit, si shpërblim për agjërim, i është premtuar takimi me Rabbin e tij.

⁵ Buhari dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a. Ky hadith është pjesë e hadithit paraprak

⁶ Buhari dhe Muslimi, transmetuar nga Sehla b. Sa’d.

Resulallahu s.a.v.s, thotë:

“Agjëruesi ka dy gëzime – gëzimi në kohën e iftarit dhe gëzimi në periudhën e takimit me Rabbin e tij.”⁷,

e me një hadith tjetër:

“Çdo gjë ka dyert e veta, e dera e ibadetit është agjërimi.”⁸,

edhe me një hadith tjetër:

“Gjumi i agjëruesit është ibadet.”⁹

Ebu Hurejre ka transmetuar nga Resulallahu s.a.v.s., se ka thënë:

“Kur fillon muaji i Ramazanit, hapen dyert e Xhennetit dhe mbyllen dyert e Xhehneimit, ndërsa shejtanët lidhen me zinxhirë. Një telall thotë:

- O ti i cili je në kërkim të së mirës, nxito! Ti i cili je në kërkim të së keqes, ik - kalo!”¹⁰

⁷ Buhari dhe Muslimi nga Ebu Hurejre.

⁸ Ibn’l Mubarek, në **‘Zuhd’**

⁹ Ebu Mensur ed-Dejlemi ne veprën **‘Musnedul-firdevs’**, transmetuar nga Abdullahu b. Ebu Evfa

¹⁰ Tirmidhiu

Fjalët e Allahut Teala:

“Ju bëftë mirë, hani e pini për atë, që keni bërë në ditët e kaluara!” 69-Hakka:24

Veki-u, i interpreton kështu:

“Bëhet fjalë për ditët e agjërimit, kur kanë lënë ushqimin dhe pijen.”

Resulallahu a.s., krahason përmbajtjen nga dynjaja (*zuhd*) dhe agjërimit duke thënë:

- Allahu Teala krahason melekët e Tij me të riun e përulur dhe thotë:

- ‘Djalosh, ti që i ke lënë dëshirat e tua për Mua, ti që sakrifikon rininë tënde për Mua, tek Unë je si njëri ndër melekët e Mi.’¹¹

Për agjëruesin, Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Allahu Teala thotë:

- ‘Shiqoni robin Tim, melekët e Mi, ka lënë dëshirat e veta, pasionet, ushqimin dhe pijen për rizanë Time.’¹²

¹¹ Ibn Adij nga Ibn Mesudi

¹² Buhariu dhe Muslimi, të cilët transmetojnë nga Ebu Hurejre, me atë që nuk janë fjalët: *“...melekët e Mi”*

Për ajetin,

“Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata, si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.” 32-Sexhde:17, në tefsir (koment) është thënë:

“... punët e mira që kanë bërë..”, është agjërimi.

Allahu Teala thotë:

“Vetëm ata që do të jenë të durueshem do të shpërblehen pa llogari.”

39- Zumer: 10.

Agjëruesit do ti jepet shpërblim pa masë; aq sa nuk mundet të parashikohet vlerësimi i tij. Zaten kështu do të duhet të jetë, ngase: edhe pse tërë sipërfaqja e tokës është pronë e Allahut – në te është nderuar Qabeja, duke u lidhur për Allahun dhe duke u quajtur **‘Bejtullah’** (shtëpi e Allahut). Dhe, sado që të gjitha ibadetet bëhen posaçërisht për Atë, vetëm agjërimi lidhet për Qenien (Dhat) e Tij, dhe sipas urdhrit:

“Agjërimi është posaçërisht për Mua”, agjërimit i bëhet nder i veçantë. Kjo ka dy sebepe:

E para është se agjërimi (*savm*) nënkupton përmbajtje dhe braktisje të ushqimit dhe pijes. Në thelbin e saj agjërimi është një ibadet i fshehtë. Të gjitha ibadetet tjera janë të dukshme, njerëzit i shohin, ndërsa agjërimin e sheh dhe di vetëm Allahu Teala. Agjërimi është një veprim i fshehtë, i cili realizohet përmes durimit.

E dyta: agjërimi është një shkas për të mposhtur shejtanin - armikun e Allahut. Sepse rruga përmes të cilës depërton shejtani i mallkuar, janë epshet, e epshet përforcohen përmes konsumimit të ushqimit dhe pijes.

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Vërtetë shejtani qarkullon në pasardhësit e Ademit ashtu siç qarkullon gjaku në trupin e njeriut! Andaj ngushtoni rrugët e tij me uri.”¹³

¹³ Buhari dhe Muslimi, transmetuar nga Safija, por pa fjalët “...ngushtoni rrugët e tij me uri”

Prandaj Resulallahu s.a.v.s., i tha Ajshes r.anha:

- **Ja Ajshe! Vazhdo të trokasësh në derën e Xhennetit.** Ajo e pyeti:

- *Ja Resulallah, me çka dhe si bëhet ajo?* Resulallahu u përgjigj:

- **Me agjërim** (uri).¹⁴

Në librin ***‘Ngrënia e tepërt dhe ilaçi i kësaj’*** do të tregojmë për të mirat e urisë.

Agjërimi bart nje veçanti në vete. Duke e mposhtur shejtanin me agjërim, ia këput atij shpresën, ia mbyll dyert dhe ia ngushton rrugët. Veçantia vjen si pasojë e lidhjes me Allahun Teala, sepse kundërshtimi i armikut të Allahut nënkupton ndihmë ndaj fesë së Allahut. Kush ndihmon Allahun, Allahu ndihmon atë. Allahu Teala thotë:

“Nëse ndihmoni Allahun, edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni të fortë në këmbët tuaja.”

47-Muhammed: 7

¹⁴ Burimi i hadithit nuk është gjetur.

Pikë së pari vije mundimi i robit për të bërë aq sa mundet, pastaj udhëzimi dhe shpërblimi është prej Allahut Teala. Për këtë Allahu Teala thotë:

“Ata që mundohen për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona.” 29-Ankebut: 69

E në ajetin tjetër thotë:

“Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete.” 13-Ra’d: 11. Në këtë ajet, me: **“derisa ata të ndryshojnë...”** mendohet në ndryshimin e dëshirave të azdisura epshore. Epshtet janë vendi i dëfrimit të shejtanëve. Përderisa epshtet të gjejnë vend për tu përhapur, shejtanët aty do të jenë të pranishëm. Dhe derisa shejtanët vijnë e shkojnë, robit nuk i shfaqet Madhështia Hyjnore, dhe nuk i mundësohet shfaqja e Tij. Kështu, Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Sikur shejtani të mos kishte qarkulluar në zemrën e njeriut, ai (njeriu) do të kishte parë botën e melekëve në qiell.”¹⁵

¹⁵ Ahmedj, trasmetuar nga Ebu Hurejre r.a.

Pra, për shkak të këtyre sebepeve agjërimi është bërë dera e ibadetit, mbrojtës nga zjarri dhe mburojë e besimtarit.

Pasi vlera e agjërimit është kaq e lartë, atëherë duhet të qartësohen kushtet e jashtme dhe të brendshme të agjërimit, duke shpjeguar parimet themelore dhe sunnetet.

Këtë do ta shpjegojmë përmes tri kapitujve.

KAPITULLI I PARË

FARZET (KUSHTET), SUNNETET DHE OBLIGIMET NË RAST TË PRISHJES SË AGJËRIMIT

KUSHTET E JASHTME TË AGJËRIMIT

Janë gjashtë kushte të jashtme të agjërimit:

1) Vëzhgimi - pritja e fillimit të muajit të Ramazanit. Kjo do të thotë shfaqja e hënës së re (*hilal*). Në rast se është koha e vranët, llogaritet që muaji (paraprak) Shaban ka tridhjetë ditë.

Kur themi 'vëzhgim' (*ru'ja*), mendojmë në njohurinë e dukshme, ndërsa njohuria mbi shfaqjen e hënës së re vërtetohet përmes dëshmisë së një personi i cili konsiderohet i drejtë. Megjithatë, vërtetësia mbi shfaqjen e hënës së re, që lajmëron fillimin e muajit Shevval ¹⁶, përcaktohet me anë të dëshmisë së dy personave të drejtë.

¹⁶ Muaj hixhri, që pason pas muajit të Ramazanit.

Kush e dëgjon nga njeriu i drejtë dhe i besueshëm se si vërtetohet se ka parë hënën e re, dhe vet një pohim të tillë e konsideron si të sinqertë, ka për obligim të agjërojë madje edhe nëse kadiu (gjykatësi) nuk sjellë vendimin mbi fillimin e agjërimit. Për këtë, secili njeri në situata të ngjashme duhet të veprojë ashtu siç i thotë mendja.

Në rast se hëna e re është parë në një qytet ndërsa në tjetrin jo, dhe largësia mes dy vendeve është më e shkurtër se dy ditë ecje, obligohen të gjithë që të fillojnë të agjërojnë.

Mirëpo, në rast se largësia mes dy vendeve është më e gjatë, atëherë secili qytet orientohet nga pozita vetanake. Në këtë rast obligimi nuk shtrihet mbi të gjithë

2) Qëllimi (nijeti). Është kusht që çdo mbrëmje, veç-e-veç, gjatë natës të bëhet nijet me bindje. Një nijet për të agjëruar tërë muajin e Ramazanit, nuk është i mjaftueshëm. Duhet të bëhet nijet veç-e-veç, për çdo natë. Nijeti gjatë ditës për të agjëruar muajin e Ramazanit (i cili është

farz) nuk është i mjaftueshëm, por për agjërimin nafile është i pranueshëm (*xhaiz*). Nëse në Ramazan thuhet: “*e bëra nijet për të agjëruar*” ose: “*e bëra nijet për agjërimin farz*” kjo për Ramazan nuk është e mjaftueshme. Por duhet konkretisht të thuhet:

“E bëra nijet për te agjëruar ditën e sotme të muajit të Ramazanit, të cilin Allahu Teala ma ka bërë farz.”

Nëse bëhet nijet natën që të agjërohet gjatë ditës së nesërme, për të cilën dyshohet se shënon fillimin e muajit të Ramazanit (*Lejletuk-Shekk*) atëherë ky nijet nuk është i mjaftueshëm sepse nuk është nijet i prerë, me përjashtim nëse vlen deklarata e dëshmitarit që me siguri ka parë hënën e re.

Eh tash, mundësia për të gabuar nga ana e dëshmitarit të drejtë apo deklaratat jo të vërteta nuk i pengojnë nijetit të prerë. Edhe dyshimi i përfundimit të muajit të Ramazanit nuk pengon nijetin e prerë. Madje nuk pengon nijetin e prerë edhe

mbështetja në mendimin personal (*ixhtihad*) për shembull, në rastin e të burgosurit në një hapësirë të errët, në rast se personi konsideron të ketë filluar muaji i Ramazanit.

Andaj, dyshimi nuk ndikon në nijet. Megjithatë, në rast se personi nuk është i sigurtë për natën e cila mendohet të jetë nata e fillimit të muajit të Ramazanit, nijeti i shprehur me gjuhë nuk llogaritet i prerë sepse vendi i nijetit është zemra. Nuk mund të mendohet dyshimi së bashku me bindje në zemër, sikur të thuhej gjatë muajit të Ramazanit: *“Do të agjëroj nesër nëse është muaji i Ramazanit”*, kjo nuk do të dëmtojë agjërimin sepse është vetëm një deklaram i thjeshtë, ndërsa nuk dëmton bindjen në zemër. Sepse ajo është një dyshim në gjuhë. Ndërsa vendi i nijetit - që është zemra - nuk përballon mëdyshjen, ajo e di se nesër është muaji i Ramazanit. Shkurt, puna është në zemër, nuk është në shprehje.

Kush bën nijet nga akshami ose gjatë natës për të agjëruar ditën e nesërme, deri në imsak, ushqehet dhe bën atë që dëshiron. Kjo gjë nuk dëmton agjërimin. Sepse nijeti është bërë për më pas imsakut. Femra e cila në kohën e ciklit menstrual bën nijet natën për të agjëruar nesër dhe pastaj i përfundon ciklin po atë natë para agimit, nuk ka nevojë të përsërisë nijetin – agjërimi i është i vlefshëm.

3) Përmbajtja nga ngrënia e qëllimshme, në rast se personi është i vetëdijshëm që është duke agjëruar. Agjërimi i personit do të priset nëse personi është ushqyer dhe ka pirë, ka marrë barëra shëruese përmes hundës apo ka bërë pastrimin e zorrëve apo është injektuar me shiringë. Në anën tjetër, agjërimi nuk do të priset nëse rrjedh gjaku, nëse lëshohet gjaku (*hixhama*), nëse vendosen pika ose grim në sy, pastrohen veshët ose pastrohet kanali urinar me shkopinjë, përveç nëse pikojnë lëngje të cilat depërtojnë në fshikëz. Njësoj, agjërimi nuk priset përmes gjërave që arrijnë të

depërtojnë në brendësinë e organizmit të njeriut, siç është pluhuri, insektet e vogla fluturuese apo sasia e vogël e ujit që hyn përmes shpërlarjes së gojës. Agjërimi priset në rast se depërton sasi më e madhe e ujit sepse atëherë është fjala për pakujdesi. Në atë mund të thuhet të jetë veprim *i qëllimshëm*.

Kemi thënë: “...në rast se personi është *i vetëdijshëm që është duke agjëruar*” sepse me këtë përjashtohet mundësia për të harruar. Do të thotë se personit nuk do t’i priset agjërimi nëse ka ngrënë diçka pa qëllim, ka harruar që është duke agjëruar.

Nëse dikush ha diçka në fillim apo në fund të ditës, d.m.th. mendon që ende ka kohë për syfyr ose është bërë koha e akshamit, e më pas konstaton se ka ngrënë në kohën kur do të duhej të ishte duke agjëruar, atë ditë duhet ta kompenzojë.

Nëse është në mëdyshje, nuk duhet asgjë. Mbi të gjitha, personi duhet të jetë i kujdesshëm në kohën e syfyrit dhe akshamit dhe mos të konsumojë ushqime ditën.

4) Përmbajtja nga marëdhëniet intime. Realizimi i marëdhënieve të tilla është depërtimi i organit gjenital mashkullor në vaginë. Në rast se vihet gjer tek marëdhënia intime si pasojë e harresës, agjërimi nuk është prishur. Nëse deri tek marëdhëniet arrihet përgjatë natës ose personi arrin tek orgazma në gjumë dhe zgjohet xhunub pas imsakut, nuk do të konsiderohet të ketë prishur agjërimin. Nëse personi pikërisht në kohën e imsakut është duke kryer marëdhënie dhe ndërpret aktin posa te vërejë, agjërimi do të konsiderohet i drejtë. Nëse vazhdon me aktin, agjërimi priset dhe lind obligimi i kompenzimit (*keffara*).

5) Përmbajtja nga ejakulimi. Ejakulimi nënkupton derdhjen e qëllimshme të spermës, qoftë ajo përmes marëdhënieve apo pa të. E gjithë kjo prish agjërimin.

Agjërimi nuk priset me puthjen e bashkëshortit/bashkëshortes apo me qëndrimin e përbashkët në shtrat nëse një gjë e tillë nuk përfundon në kryerjen e

marëdhënieve. Por edhe kjo del të jetë e papëlqyer (*mekruh*), vetëm nëse bëhet fjalë për person më të moshuar apo person i cili mund të kontrollojë instiktet e veta.

Puthja nuk pengon asgjë, mirëpo është e preferueshme që njeriu të përmbahet edhe nga një gjë e tillë.

Nëse personi konstaton se puthja mund t'a nxit tek ejakulimi dhe puth bashkëshorten dhe derdh spermën, agjërimi priset për shkak të pakujdesisë së tij. (Sipas Hanefive në një rast të tillë, nuk priset).

6) Përmbajtja nga vjellja. Vjellja prish agjërimin. Mirëpo nëse diçka e tillë ndodhë papritmas, atehere agjërimi nuk priset. Në rast se personi gëlltit pështymën ose këlbazën nga fyti, agjërimi nuk do të priset, në bazë të principit të lehtësimit (*ruhsa*).

Mirëpo nëse personi gëlltit pështymën ose këlbazën pasi që ka arritur në gojë, atëherë agjërimi priset. (Sipas Hanefive nuk priset.).

Ekzistojnë katër dënime në rast të ndërprerjes së agjërimin:

1. Kadha¹⁷
2. Kompensimi (keffara)¹⁸
3. Përmbajtja nga ushqimi për pjesën e mbetur të ditës, sikur personi të jetë me të vërtetë agjëruar.
4. Kompensimi përmes të ushqyerit të tjetrit (*fidja*),

1. *Kadha* është obligim i përgjithshëm i çdo muslimani, akt ligjrisht i detyrueshëm për personin (*mukellef*), i cili nuk ka agjëruar, pa marrë parasysh në atë se a ka pasur arsye apo jo. Edhe femra përgjatë ciklit mujor detyrohet të agjërojë ditët e humbura, poashtu edhe ai që largohet nga

¹⁷ **Kadha**: të agjërohen më pas ditët e humbura të agjërimin.

¹⁸ **Keffara**: sadaka ose agjërimi për falje të një gjynahi.

Islami dhe prap kthehet në Islam (*murted*) duhet të agjërojë ditët e kaluara (sipas Hanifive nuk i agjëron). Por jobesimtari (*qafir*), fëmiu dhe personi me çrregullime mendore nuk kanë obligim të agjërojnë. Kompenzimi i ditëve të humbura të muajit të Ramazanit, nuk janë kusht për tu agjëruar me radhë ditë pas dite, për shembull: agjëron një ditë dhe pushon ditën tjetër, agjëron tri ditë e pushon dy ditë, etj.

2. *Kompenzimi* (keffara) është obligim vetëm në raste të marëdhënieve intime në ditën e Ramazanit kur personi është i vetëdijshëm që është duke agjëruar. Obligimet e keffara-së nuk vlejnë në rastin e ejakulimit spontan, të ushqyerit dhe pijes, e asgjë tjetër që nuk është pjesë e marëdhënieve intime. (Sipas Hanifive, në rastin e masturbimit nuk duhet. Por me vetëdije dhe në raste të paarsyeshme duhet). Obligimi i keffaretit ka të bëjë me lirim të skllavit. Nëse kjo për personin del të jetë e vështirë, atëherë kalon në agjërim

dymujor të plotë (pa ndërprerje në mes). Nëse edhe për këtë është i pafuqishëm, atëherë duhet të ushqejë gjashtëdhjetë persona të varfër ose të ushqyerit e një personi të varfër gjashtëdhjetë ditë.

3. *Përmbajtja nga ushqimi* përgjatë ditës është obligim për personin i cili më qëllim ka prishë agjërimin apo një gjë të tillë e ka bërë nga pakujdesia.

Kjo nuk del të jetë obligim për femrën cikli i së cilës përfundon gjatë ditës e më pas pastrohet, as i udhëtarit (mysafir) i cili në rrugëtimin e gjatë më së paku dy ditë ecjeje ka arritur në shtëpi në kohën e agjërimit.

Obligimi për t'u përmbajtur vlen edhe për personin të cilit një njeri i drejtë i ka dëshmuar të ketë parë hënën e re në ditën në të cilën nuk dihet me të vërtetë në të ketë filluar muaji i Ramazanit (*jev-m-i shekk*).

Agjërimi në rrugë është më i mirë sesa mos-agjërimi, me përjashtim nëse personi nuk arrin të përballojë diçka të tillë. Ditën kur niset për në rrugë dhe tashmë ka agjëruar në kohën kur ishte në vendin e vet (*mukim*), për të agjërimi do të jetë i plotë. Poashtu, obligimi i agjërimit do të njihet nëse personi kthehet në shtëpi si agjërues.

4. *Kompenzimi përmes të ushqyerit të tjetrit*, është obligim i gruas shtatëzënë dhe asaj që jep qumësht nga gjiri, të cilat nga frika për gjendjen e fëmiut, duhet të japin nga një '*mud*'¹⁹ miell gruri personit të varfër për çdo ditë që nuk e kanë agjëruar, dhe pastaj i agjëron këto ditë. (Sipas Hanefive është i detyrueshem agjërimi, ndërsa nuk është e detyrueshme dhënia e fidjes.)

Personi që është në moshë të shtyer dhe nuk agjëron shkaku i moshës, duhet të jap një '*mud*' (sasinë e sadakasë) për çdo ditë.

¹⁹ Sipas Hanefive, me 3333 gram, bukë mielli ushqen të varfërin në mëngjes dhe mbrëmbe. Pra, me bukë, e jo gjithsesi edhe me gjellë. Nëse nuk ka mundësi për këtë, atëherë bën teube dhe istigfar.

SUNNETET E AGJËRIMIT

Janë gjashtë sunnete të agjërimit:

1. Vonesa e syfyrit, pra të ushqehemi deri në kohën e imsakut.

2. Ngutia me iftar - prishja me hurme (dimrit) ose ujë (verës), para namazit.

3. Mospërdorimi i misvakut pasi dielli kalon zenitin, pra të përdoret misvaku gjatë mbrëmjes.

4. Kryerja e veprimeve të mira në muajin e Ramazanit, të tregohet më bujarë (i xhymertë), për çka kemi folur në kapitullin për zekatin.

5. Leximi i Kur'anit.

6. Tërheqja në i'tikaf në xhami, posaqërisht në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit, siç bënte Resulallahu s.a.v.s.

“Kur hynte pjesa e tretë (e fundit), mbështjellte shtratin, e lidhte izar-in²⁰, përgaditej për ibadet, e edhe ehli-bejtin e përgadiste për ibadet”.²¹

²⁰ Izar: roba me të cilat mbulojmë trupin prej gjoksit poshtë

²¹ Buhari dhe Muslimi nga Ajsha r.anha.

Do të thotë, në veçanti këmbëngulte në ibadet, pasi që në këtë kohë del të jetë Nata e Kadrit (*Lejletul-Kadr*), e sipas mendimeve të shumicës, ajo bjen në netët tek, derisa ndoshta ajo mund të jetë nata e njëzet e një, njëzet e tre, njëzet e pesë, a njëzet e shtatë.

Preferohet që i'tikafi të bëhet pandërprerë në vazhdimësi. Nëse bëhet nijet për t'iu kushtuar i'tikafit pandërprerë në vazhdimësi, do të thotë bën nijet për të qëndruar dhjetë ditë në xhami për të bërë ibadet, pastaj nëse del nga xhamia pa nevojë dhe pa arsye, ndërpritet vazhdimësia, siç është shembulli për shkak të vizitës së bërë tek i sëmuri, në gjykatë, xhenaze, vizitë e thjeshtë dhe pa arsye larjeje. Nëse dilet shkaku i kryerjes së nevojave, vazhdimësia e procesit nuk do të ndërpritet, e atëherë personi mund të marr abdes ne shtëpinë e vet.

Megjithatë, nuk do të duhej të merren me punë të tjera.

Resulallahu s.a.v.s.v., gjatë qëndrimit në i'tikaf dilte vetëm për nevojë. Edhe pyeste për gjendjen e të sëmurit kalimthi.

Vazhdimësia do të ndërpritet nëse vie deri te kryerja e marëdhënieve por jo nëse vihet deri te puthja.

Nuk ka pengesa nëse personi në xhami rregullohet, të kurorëzohet, të ushqehet dhe të pijë e më pas të pastrojë duart në legen. Sepse kjo personit i duhet për i'tikaf i cili zgjat dhjetë ditë. I'tikafi nuk do të ndërpritet nëse personi nga xhamia shfaq një pjesë të trupit të vet. Ngase:

“Resulallahu, s.a.v.s., duke qenë në i'tikaf e nxirrte kokën jashtë nga dera e mesxhidit dhe hazreti Aishja nga dhoma e saj e lante dhe e krihte.”²²

Kur personi i cili gjindet në i'tikaf del për shkak të kryerjes së nevojave, pas kthimit mbrapa duhet të përsëritet nijeti. Por nëse ka bërë nijet në fillim për dhjetë ditët, atëherë nuk është i detyrueshëm të përsëritet nijeti. Mirëpo, për çdo rast, më mirë është të përsërisë nijetin.

²² Buhari dhe Muslimi nga Ajsha r.anha.

KAPITULLI I DYTË

FSHEHTËSITË E AGJËRIMIT DHE KUSHTET E BRENDSHME

Dije se, agjërimi është tri shkallë:

1. Agjërimi i avam-it (*i të rëndomtit*).
2. Agjërimi i havass-it (*i të veçantit*)
3. Agjërimi i havassu'l-havass (*i të shkëlqyerit nga të veçantit*)

Agjërimi i avam-it, përbëhet nga ruajtja e barkut dhe organeve nga kërkesat e epsheve, ashtu siç e kemi shpjeguar hollësisht.

Agjërimi i havass-it, përveç këtyre që i cekëm për avam, përbëhet edhe nga përmbajtja e veshit, syrit, gjuhës, duarve, këmbëve dhe pjesëve të tjera të trupit nga gjynahet.

Agjërimi i havassu'l-havass, përveç këtyre që i cekëm për avam dhe havas, përbëhet edhe në nxjerrjen nga zemra të dëshirave të pavlera e të mendimeve të dynjallëkut, dhe duke tërhequr zemrën nga

çdo gjë përveç lidhjes me Allahun Teala; me tërë ekzistencën të lidhet për Allahun dhe vetëm Atë ta ruajë në kujtesë. Të tillëve u prishet agjërimi në atë çast kur në zemër hyjnë mendimet jashta Allahut Teala dhe ahiretit.

Vetëm se, nuk është pengesë të mendohen pjesët e dobishme të dynjallëkut, për ahiret. Bile, zemra të tilla që posedojnë këtë gjendje kanë thënë:

- Kush mendon gjatë agjërimit për atë se çka do të hajë në iftar, i shënohet gjynah në fletore. Sepse është shenjë e mungesës së besimit në mirësinë e Allahut, besimin e dobët në furnizimin e premtuar.

Kjo është shkalla e pejgamberëve, sidikëve dhe mukarebunëve.

Nuk duhet ndalur në përshkrimin e detajizuar verbal, por t'i kushtohet rëndësi ngritjes në një shkallë të tillë.

Agjërimi i tillë, nënkupton arritjen në shkallën më të lartë - rizanë (kënaqësinë) e

Allahut Teala, duke lënë çdo gjë përveç Atij, sipas fjalëve:

“Thuaj: “Allah!” Mandej lëri ata të luajnë në atë kotësinë e tyre.”

6-En’amë: 91

Agjërimi i të veçuarve, pra agjërimi i të mirëve është ruajtja e tërë organeve nga bërja e gjynaheve, dhe kjo përmbushet përmes gjashtë kushteve:

1. Parandalimi i shikimit (syrit), përpjekja e njeriut të mos ngul sytë në atë që është e papëlqyeshme dhe e neveritshme dhe në çdo gjë që ia okupon zemrën dhe e pengon nga kujtimi i Allahut Teala.

Resulallahu, a.s., thotë:

“Shikimi me epsh është një ndër shigjetat e helmueshme të Iblisit, Allahu e ka mallkuar. Andaj kush atë e braktis, duke iu frikësuar Allahut, Allahu Teala do t’i jap një iman të tillë që kënaqësinë do t’a ndjejë në zemër.”²³

²³ Hadithin shënon Hakimi nga Huzejfe.

Xhabiri r.a., transmeton nga Enesi se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Pesë gjëra e prishin agjërimin:²⁴ gënjeshtër, përgojimet, bartja e fjalëve jo të pëlqyera tek tjetri, betimi jo i vërtetë dhe shikimi me epsh (*en-nezar bi shehva*)”²⁵

2. Parandalimi i gjuhës nga fjalët boshe, përgojimi, gënjeshtër, fjalët (shprehjet) e ndyta, fyerjet, llomotitjet, grindja dhe përleshja. Obligim i agjëruetit është heshtja, dhikri dhe leximi i Kur’anit. Kjo do të thotë agjërim i gjuhës. Bishr b. Haris transmeton nga Sufjani Sevriu se kishte thënë:

- Përgojimi prish agjërimin.

Sipas transmetimit të Lejsit, edhe Muxhahidi ka thënë:

- Dy gjëra prishin agjërimin: përgojimi dhe gënjeshtër.

²⁴ “*Prishin agjërimin*”, domethënë pakësohet sevapi dhe agjërimi nuk bëhet i përkryer. Përndryshe, edhe pse janë në esencë haram, ato nuk e prishin agjërimin.

²⁵ El-Ezdi, në ‘*Zuaf.*’

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Agjërimi është një mburojë. Kur dikush nga ju është agjëruar, të mos flas fjalë të këqija dhe të mos bëj budallallëqe. Nëse dikush tjetër dëshiron të grindet me të apo e fyen, atëherë ai duhet t'i thotë atij dy herë: 'Jam agjërueshëm, jam agjërueshëm.’”²⁶

Prap në një lajm është shënuar:

Në kohën e Resulallahut s.a.v.s., dy gra që ishin duke agjëruar, para përfundimit të ditës erdhën në një gjendje të lodhur për vdekje nga uria dhe etja. E dërguan një person tek Resulallahu s.a.v.s., që t'i lejojë të ndërprejnë agjërimin. Resulallahu s.a.v.s., iu dërgoi një enë dhe u tha:

- I thua që të djave që brenda në enë t'a vjellin atë që kanë ngrënë. Volli njëra, gjysma e së vjellurës ishte gjak i kuq dhe mish i freskët. Edhe tjetrës i ngjau njësoj. U mbush ena.

²⁶ Buhariu dhe Muslimi nga Ebu Hurejre r.a.

U tronditën njerëzit ndërsa Resulallahu s.a.v.s., tha:

“Kanë agjëruar me atë që Allahu Teala u ka lejuar ndërsa e kanë ndërprerë më atë që Allahu u ka ndaluar. Janë ulur njëra me tjetrën dhe kanë përgojuar njerëzit dhe ja mishi të cilin e kanë ngrënë përmes një veprimi të tillë.”²⁷

3. Parandalimi të dëgjuarit (veshit), sepse çdo gjë që është e ndaluar për t’u folur rreth saj njashtu është e ndaluar edhe të dëgjohet. Për këtë arsye Allahu Teala ka barazuar atë i cili dëgjon gjëra të ndaluara me atë që ha të ndaluarën (haram):

“Ata janë dëgjuar të gënjeshtres dhe e hanë me kënaqësi të madhe atë që është e ndaluar.” 5-Ma’ide: 42

Prap Allahu Teala thotë:

“E, pse paria fetare të mos i ndalin nga ato thënie të tyre të rreme dhe nga ngrënia e haramit.” 5-Ma’ide: 63

²⁷ Ahmedi nga Ubjedi.

Prandaj është e ndaluar të mos reagohet kur përgojohet dikush. Sepse, Allahu Teala thotë:

“Përndryshe, ju do të jeni si ata.”

4-Nisa: 140

Edhe Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ai i cili përgojon dhe ai i cili e dëgjon, janë ortak në gjynah.”²⁸

4. Parandalimi i gjymtyrëve nga kryerja e gjynaheve, dorës dhe këmbës nga punët jo të pëlqyera, dhe barkut nga kafshatët e dyshimta në kohën e iftarit.

Sepse nuk ka asnjë kuptim nga ngrënia hallall në syfyr, kur hahet haram në iftar.

Agjëruesi i tillë është sikur personi i cili ndërton shtëpi ndërsa rrënon qytetin. Ushqimi hallall shkakton dëm nëse konsumohet shumë, mirëpo vetë si hallall nuk është i dëmshëm. Agjërimi do të thotë pakësimi i sasisë. Lënia me bujari e konsumimit të ilaçit nga frika se mos e dëmton njeriun është zgjuarësi, ndërsa

²⁸ Teberani nga Ibn Omeri.

marrja e helmit është budallallëk i vërtetë. Njëjtë, edhe harami është një helm që shkatërron fenë. Ndërsa hallalli është ilaçi i cili përdoret në sasi të vogla, por që mund të dëmtojë nëse merret në sasi të mëdha. Qëllimi i agjërit është pakësimi i konsumimit të hallallit. Ndërkaq Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ka shumë agjërues që nga agjërimi i tyre nuk kanë tjetër dobi vetëm uri dhe etje.”²⁹

Disa interpretojnë se të tillët janë pikërisht ata që bëjnë iftar me haram. Të tjerët konsiderojnë se të tillët janë pikërisht ata agjërues që kanë përgojuar njerëzit. Sepse përgojimi është haram. E disa të tjerë kanë thënë se të tillët janë ata që nuk kanë ruajtur gjymtyrët nga gjynahet. Atëherë, agjëruesi duhet të ketë kujdes nga të gjitha këto.

5. Në kohën e iftarit të hahet pak - të mos merret ushqim tejmase, as në kohën e iftarit të mos mbushet barku, sepse nuk ka

²⁹ Nesai dhe Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre r.a.

enë të mbushur më të papëlqyer për Allahun Teala sesa barku i stërmbushur me ushqim, qoftë ai edhe hallall.

Si do të shtyp shejtanin, që është armiku i Allahut dhe të thyejë epshet, kur agjëruesi gjatë kohës së ngrënies e kompenson gjithë ushqimin që e ka lënë anash gjatë ditës, dhe për më tepër rrit sasinë e ushqimit dhe pijes? Është bërë një zakon që, gjatë ramazanit, të përgatiten ushqime të llojllojshme, sa ndoshta as gjatë muajve të tjerë nuk hahen ato lloje ushqimesh.

Është e ditur që qëllimi i agjërimit është boshatisja e barkut nga ushqimi, thyerja e epsheve dhe arritja në devotshmëri. Kur personi nuk ka ngrënë asgjë gjatë ditës gjer deri në mbrëmje dhe epshi dobësohet e më pas njeriu shijon gjëra nga më të ndryshmet dhe ëmbëlsohet e pi, kënaqësia veçse forcohet bashkë me epshin dhe arrin masën të cilën nuk do të arrinte po qe se nuk do të kishte sjellje të tilla.

Shpirti i agjërimit dhe fshehtësia e tij janë dobësimi i rrugëve të shejtanit dhe shtypja e tij, për ta kthyer njeriun nga e keqja. Kjo mund të arrihet vetëm me zvogëlimin e konsumimit të ushqimit dhe kjo do të thotë ngrënia në iftar në sasi normale - aq sa do të konsumohej në rast se nuk do të ishim duke agjëruar.

Nëse gjatë iftarit kompensohet sa dy dreka, agjërimi nuk ka dobi. Madje edhe nga urtësia (edeb) është që të flihet pak gjatë ditës në mënyrë që të ndjehet uria dhe etja, të ndjehet humbja e fuqisë me anë të së cilës pastrohet zemra. Dhe me lehtësi do të mund të falë namazin e natës dhe të bëjë virdin (ibadetet vullnetare të rregullta), gjithë kjo që shejtani të mos qarkullojë nëpër zemër që do t'i mundësohet njeriut të shoh të shenjtët e padukshëm qiellorë (bota e melekutit).

Nata e Kadrit (*Lejletul-Kadr*) shënon natën ku zbulohet diçka nga bota e melekutit, në atë mendohet me fjalët:

“Ne e kemi zbritur (Kur’anin) në Natën e Kadrit.” 97-Kadr: 1

Andaj, kush mbush torbën e ushqimit në mes të zemrës dhe gjoksit, atë natë do të jetë i penguar nga soditja shpirtërore.

Për ngritjen e perdes nuk do të jetë e mjaftueshme vetëm zbrazja e stomakut, derisa nuk lirohet nga të gjitha dëshirat, përveç dëshirës për të përfitur rizanë e Allahut Teala.

Ndërsa e gjithë kjo nis me zvogëlimin e sasisë së ushqimit. Për këtë do të flasim në kapitullin mbi ushqimin, inshallah.

6. Zemra e agjëruesit pas iftarit duhet të rrahë në mes të frikës (*havf*) dhe shpresës (*rexha*), sepse ai nuk e di a do t'i pranohet agjërimi me çka do të vlerësohet në mes të atyre të afërmëve (*mukarrebun*), apo do t'i refuzohet agjërimi që do të vlerësohet në mes të atyre të urryer. Këto sjellje duhet ti posedojmë pas përfundimit të çdo forme të ibadetit.

Transmetohet se Hasan ibn Ebu Hasan el-Basriu në ditën e Bajramit kaloi para një grupi njerëzish të cilët argëtoheshin dhe qeshnin me zë. Në atë tha:

- *Allahu Teala ka bërë muajin e Ramazanit si një mejdan. Njerëzit garojnë me ibadet. Kush e fiton garën - shpëton, ai që humb - shkatërrohet. Në të vërtetë çuditë nga sjelljet e personave që qeshen dhe argëtohen në ditën kur ata të cilët respektojnë detyrimet fitojnë ndërsa ata të cilët i neglizhojnë, janë të pikëlluar dhe në humbje. Vallahi, nëse Allahu Teala do të ngriste perden dhe hakikati shfaqet, gëzimi i personit të cilit i janë pranuar veprat (agjërimi), do e ndalonte edhe argëtimin, ndërsa pikëllimi i personit të cilit i janë refuzuar veprat, do e ndalonte të qeshurit.*

Ahnefa ibn Kajs-it dikush i kishte thënë se është tejet i moshuar të agjërojë ndërsa agjërimi do e dobësonte edhe më shumë, në çka është përgjigjur:

- *Agjërimin e kuptoj si një kapital për rrugë të gjatë. Më lehtë e kam që sot të duroj vështirësitë e axhërimit, se sa t'i bëj durim dënimit të Allahut Teala.*

Eh, ky është kuptimi i brendshëm i agjërimit.

Pyetje:

Nëse thuhet, fakihët thonë se agjërimi i drejtë i personit është të braktiset ushqimi, pija dhe mardhëniet intime, çfarë do të thotë tash kjo?

Dije se: fakihët, te cilët merren me anën e jashtme, kanë themeluar kushtet e jashtme me dëshmi më të dobëta nga ato që i kemi specifikuar më herët, duke i numëruar në kuadër të kushteve të brendshme, në veçanti përgojimet (*gijbet*) dhe ngjashëm. Fakihët theksojnë ato obligime që nuk do i bien si barrë e rëndë njerëzve të shkujdesur (*gafil*) ndër ta edhe të tillë që kanë lidhje të fortë me këtë botë. Megjithatë, dijetarët e ahiretit janë të zënë me pranimin e agjërimin, dhe me pranimin e asaj që synojnë arritjen në qëllim. Dijetarët e tillë e kuptojnë që qëllimi i agjërimin është dekorimi me një nga tiparet e Allahut Teala, me tiparin e *samedijet*-it, që mos të ketë nevojë për asgjë - përveç Allahut, gjithashtu aq sa është e mundur largimi nga epshet dhe përshtatja

melekëve. Sepse melekët janë te pastër nga epshet. Njeriu ndodhet në një shkallë më të lartë sesa kafshët, sepse me ndihmën e mendjes i mjafton fuqia të zotërojë epshet, e një shkallë më poshtë se melekët sepse e kaplojnë epshet e njeriu është i ngarkuar të luftojë kundër epsheve. Saherë personi u dorëzohet epsheve, bie në botën e qenieve më të ulëta dhe shkallës së kafshëve.

Ndërsa saherë mposht epshet, ngritet në shkallën më të lartë *ala-i illijun*, shkallën e melekëve. Ndërsa melekët janë krijesa të afërta të Allahut Teala andaj kush i pason dhe dekorohet me tiparet e tyre do jetë i afërt me Allahun Teala, sikur që janë melekët. Në këtë kontekst, duke imituar të afërmit, arrihet afërsia, sepse afërsia nuk nënkupton afërsinë e vendit, por të tipareve.

Nëse kjo është fshehtësia e agjërimit, sipas mendimit të njerëzve që mbizotërojnë me zemrat e tyre dhe atyre që ndjekin bukurinë e zemrës, çfarë dobie nga vonesa e ushqimit, pas konsumimit të të gjitha llojeve ushqimit në iftar, duke iu dorëzuar

plotësisht epsheve? Nëse një gjë e tillë ka kuptim, cila është domethënia e fjalëve të Resulallahut s.a.v.s.:

“Ka shumë agjërues që nga agjërimi i tyre nuk kanë tjetër dobi vetëm uri dhe etje.”

Prandaj Ebu’d Derda r.a., ka thënë:

- Sa i bukur është gjumi i njerëzve të matur dhe të ushqyerit e tyre! Përmes sjelljeve të tyre, si vihen në pah gabimet e të paditurëve që agjërojnë. Një grimcë e adhurimit të njeriut të devotshem i cili i bindet Allahut Teala është më me vlerë dhe më e madhe sesa adhurimi sa malet të cilin e praktikojnë të paditurit.

Andaj një dijetar ka thënë:

- Sa ka nga agjëruesit, që nuk agjërojnë, e sa ka nga ata që hajnë e pijnë e që agjërojnë.

Ai që ha e pi e që agjëron është ai i cili ruan pjesët e trupit nga gjynahet, ndërsa ushqehet dhe pi.

Në anën tjetër, agjëruesi i cili nuk agjëron, është ai i cili nuk ha e pi ndërsa organet e tij i lë të veprojnë sipas dëshirës.

Ai i cili kupton domethënien dhe fshehtësinë e agjërimit e di se personi i cili braktis ushqimin e pijen dhe marrëdhëniet intime e i cili nuk ruhet nga e keqja, është ngjashëm si personi i cili në abdes një gjymtyrë tri herë e fërkon në të thatë, pa derdhur ujë në gjymtyrë. Në pamje të parë i përshtatet numrit, por nuk përdorë ujin që është esencial. Padyshim që këtij personit nuk i pranohet namazi.

Ndërsa ai i cili nuk agjëron dhe ruan gjymtyrët nga e keqja është si personi i cili gjymtyrët i lanë me ujë, pa i fërkuar një herë. Këtij personi namazi i pranohet, inshallah, sepse ka përmbushur farzin, madje edhe nëse ka lënë anash veprimet pasuese që janë të obligueshme.

Ndërsa ai i cili ka agjëruar dhe ka ruajtur veten nga e keqja është i ngjashëm me personin i cili ka larë gjymtyrët me ujë nga tri herë, duke i fërkuar.

Ka përmbushur që të gjitha veprimet esenciale, edhe ato përcjellëse.

Resulallahu ka thënë:

“Agjërimi është amanet, secili prej jush ta ruajë këtë amanet.”³⁰

Kur Resulallahu s.a.v.s., e lexoi ajetin:

“Allahu ju urdhëron që t’u jepni amanetin të zotëve të tyre.” 4-Nisa: 58

duke treguar me dorë veshin dhe syrin, tha:

‘Edhe veshi është amanet, edhe syri është amanet.’

Nëse e gjithë kjo nuk është nga amaneti i agjërimit, atëherë përse Resulallahu s.a.v.s. ka udhëzuar të thuhet në rastin e fyerjes:

“Unë jam duke agjëruar”,

³⁰ Haraiti në **“Mekarim-i Ahlak”**, transmetuar nga Ibn Mesuda.

domethënë, u zotuar të mbajmë gjuhën si amanet, andaj si t'ia jap gjuhës lirinë për t'iu përgjigjur fjalëve tua?

Nga këto shpjegime është kuptuar se çdo ibadet ka zahirin e vet (aspektin e jashtëm) dhe batinin e vet (aspektin e brendshëm), lëvoren dhe esencën. Lëvorja ka shkallët e veta dhe çdo shkallë ka shtresën e saj. Tash të mbetet ty zgjedhja nëse do të kënaqesh me lëvoren, apo do të zhytesh në esencë e të jesh mes atyre të cilët e kuptojnë hakikatin me zemër.

KAPITULLI I TRETË

AGJËRIMET VULLNETARE (NAFILE) DHE RENDITJA E TYRE

Dije se, është e lavdërueshme (mustehab) të agjërohet gjithmonë. Por në ditët të vlefshme është edhe më e pëlqyeshme. Disa nga këto ditë të vlefshme ndodhen brenda vitit, disa brenda muajit, e disa brenda javës.

Ditët e vlefshme në vit, pas muajit të Ramazanit janë ditët e Arefe (*Jevm Arefe*), dita e Ashures (*Ashura*), dhjetë ditët e para të muajit Dhyl-hixhxhe dhe dhjetë ditët e para të muajit Muharrem, të agjërohet në muajt e vlefshëm (Rexhep, Dhyl-ka'de, Dhyl-hixhxhe dhe Muharrem). Këto janë ditët e vlefshme për t'u agjëruar brenda vitit.

“I Dërguari i Allahut, Muhammedi, s.a.v.s., agjëronte shumë në muajin Shaban sa dikush mendonte se ka hyrë muaji Ramazan.”³¹

Në njoftim rreth kësaj është thënë:

“Pas muajit të Ramazanit, më me vlerë është të agjërohet në muajin Muharrem.”³²

Sepse muaji Muharrem është fillimi i vitit ndërsa viti është mirë të fillohet me të mirë, që të mund të pritët bekim i vazhdueshëm.

Resulallahu, a.s., ka thënë:

“Agjërimi i një dite të muajit të shenjtë (*Esh’hur-i hyrum*) është sa tridhjetë ditë agjërim në ndonjë muaj tjetër. Ndërsa agjërimi i një dite në muajin e Ramazanit është më i mirë së tridhjetë ditë agjërim në njërin nga muajt e shenjtë.”³³

³¹ Buhariu dhe Muslimi nga Ajsha r.anha.

³² Muslimi nga Ebu Hurejre

³³ Hadithin nuk e kam gjetur në këtë formë. Tek autori Teberani në veprën *el-Muxhemus-sagir*, ekziston hadithi që transmeton Ibn Abbasi, si vijon: “*Kush agjëron në*

Në një hadith tjetër thuhet:

“Kush agjëron tri ditë përgjatë një muaji të shenjtë: e enjte, e premte dhe e shtunë, Allahu Teala për çdonjerën nga ditët do t’i shënojë 700 vite sevape të ibadetit.”³⁴

Poashtu në lajm thuhet:

“Kur hyn pjesa e dytë e Shabanit, nuk ka agjërim deri në fillimin e muajit të Ramazanit.”³⁵

Për shkak të këtij hadithi thuhet të jetë e lavdërueshme (mustehab) të mos agjërohet disa ditë para muajit të Ramazanit. Mirëpo nëse bashkohen agjërimi i muajit Shaban dhe muajit Ramazan, edhe një gjë e tillë është e lejuar³⁶ sepse Resulallahu s.a.v.s., njëherë i

muajin Muharrem, për çdo ditë do t’i shënohet sikur të këtë agjëruar tridhjetë ditë”

³⁴ El- Ezdi në **‘Dhuafa’**

³⁵ Hadithin shënojnë të katërtit (Ebu Davud, Tirmidhiu, Nesai dhe Ibn Maxhe), nga Ebu Hurejre

³⁶ Hadithi: **“Njëhere ka bashkuar agjërimin e muajit Shaban me agjërimin e muajit Ramazan”** shënojnë të katërtit (Ebu Davud, Tirmidhiu, Nesai dhe Ibn Maxhe), transmetuar nga Umm Seleme.

ka bashkuar agjërimin e muajit Shaban dhe muajit Ramazan, mirëpo megjithatë më shpesh edhe i ka ndarë.³⁷

Nuk është e lejuar që qëllimisht të pritet muaji i Ramazanit me agjërim në dytri ditët paraprake, vetëm nëse rastësisht ndodhë në ditët e agjërimin të zakonshëm të personit, atëherë është e padëmshme.

Disa nga as'habët e kanë konsideruar të papëlqyeshme (*mekruh*) agjërimin e tërë muajit të Rexhepit në mënyrë që disa nga agjëruerit të mos e përjetojnë si muajin e Ramazanit.

Muajt me vlerë janë: Dhyl-hixhxhe, Muharrem, Rexhep dhe Shaban. Muajt e shenjtë (*Esh-hur-i hurum*) janë: Dhyl-ka'de, Dhyl-hixhxhe, Muharrem dhe Rexhep.

Dhyl-ka'de, Dhyl-hixhxhe dhe Muharrem vijnë njëri pas tjetrit, nërsa muaji Shaban vie ndaras.

Muaji më me vlerë nga këta është muaji Dhyl-hixhxhe, sepse në këtë muaj është farzi i haxhit, Ejjam-i ma'lumat (ditët

³⁷ Hadithi: "***Shpesh ndante Shabanin nga muaji i Ramazanit***" shënon Ebu Davud, nga Ajsha r.anha.

e njohura) dhe Ejjam-i ma'dudat (ditët e numëruara). Muaji Dhyl-ka'de është muaj i shenjtë dhe në të janë ditët e haxhit. Ditët e haxhit janë edhe në muajin Sheval i cili nuk është ndër muajt e shenjtë. Në muajt Muharrem dhe Rexhep nuk janë ditët e haxhit. Në lajm thuhet:

- Në asnjërën nga ditët, veprat nuk janë aq me vlerë dhe më të dashura tek Allahu Teala sesa dhjetë ditët e Dhyl-hixhxe. Agjërimi në njerën nga këto ditë është baraz me një vit agjërim, ibadetet e bëra në njërën nga këto netë është baraz me Natën e Kadrit (Lejletul-Kadr). Në atë, (njerëzit) thanë:

“As edhe xhihadi në rrugën e Allahut (në ditët tjera nuk është i barabartë me ditët e këtij muaji)?” Muhammedi, a.s., tha:

- As xhihadi në rrugën e Allahut, me përjashtim të personit të cilit i është derdhur gjaku, dhe i ka pësuar kafsha kalëruese.³⁸

³⁸ Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre.

Këto ishin agjërimet me vlerë brenda vitit.

Agjërimi mujor:

Ditët e veçanta që shfaqen në çdo muaj, janë fillimi, mesi dhe fundi i muajit.

Ditët nga mesi emërohen si '*ditët e bardha*', ndërsa ato janë ditët 13, 14 e 15 në çdo muaj të vitit (hixhri).

Agjërimi javor:

Ditët e veçanta që janë pjesë përbërëse e çdo jave janë dita e hënë, e enjte dhe e premte. Në ato ditë është e pëlqyeshme (*mustehab*) të agjërohet dhe të shpreshtohen veprat e mira, në mënyrë që të rritet shpërblimi me bekim përgjatë asaj periudhe.

Agjërimi vjetor:

E tash, agjërimi pa ndërprerje (*savmu'd-dehr*) përfshin që të gjitha agjërimet e përmendura, dhe më tepër. Rreth agjërimit pa ndërprerje ekzistojnë mendime të ndara.

Disa, agjërimin e tillë e konsiderojnë të papëlqyer (*mekruh*) sepse ekzistojnë hadithe që flasin për diçka të tillë.

Por, është mendim i drejtë që ky lloj agjërimi të jetë jo i pëlqyer (*mekruh*) në këto dy raste:

E para, nëse agjërohet në ditët e bajramit dhe teshrikut.³⁹

E dyta, nëse me këtë braktiset sunneti lidhur me iftarin dhe me agjërim i krijojmë vetes barrë dhe presion, megjithëse Allahu Teala, robit të Vet i ka dhënë leje për iftar.

Ndërsa Allahu Teala, siç dëshiron që robi i Vet të zbatojë urdhërat pa të meta dhe në mënyrë të saktë, me lejen e Tij dëshiron edhe t'ia lehtësojë zbatimin e veprimeve robit.

³⁹ Hadithi tregon që është *mekruh* të agjërohet pandalur. Shënon Buhari dhe Muslimi, transmetuar nga Abdullah ibn Amr. Në hadithin që shënon Ibn Maxhe thuhet: "***Nuk ka agjërim kush agjëron pandalur.***" Në tregimin e dytë, te Muslimi, që transmeton Ebu Katade, thuhet: "***Dikush ka thënë: 'O i Dërguar i Allahut, çka është me atë i cili pandërprerë agjëron?' I Dërguari, a.s., u përgjigj: 'As nuk agjëron, as nuk rri pa agjëruar.'***" Ngjashëm shënon Nesai, duke transmetuar nga Abdullah ibn Omeri, Imran ibn Husejni dhe Abdullah ibn-esh-Sihhira.

Nëse tek personi nuk shfaqet asnjëra nga situatat e lartpërmendura, por agjërimi pa-ndërprerje (përveç bajramit dhe teshrikut) bëhet për selametin e vet, atëherë çasja është e lejueshme.

Këtë lloj agjërimi e kanë praktikuar një pjesë e as'habëve dhe tabiinëve r.a. Allahu qoftë i kënaqur me ta.

Në hadithin që transmeton Ebu Musa Esh'ariu, Resulallahu, a.s., thotë:

“Për atë që agjëron tërë vitin, Xhehenemi ngushtohet dhe për këtë person nuk ka vend aty. Ai vendoset mbi nëntëdhjetë një.”⁴⁰

Ekziston një shkallë më poshtë nga kjo e ajo është agjërimi i gjysmës së vitit, që do të thotë se personi një ditë agjëron ndërsa ditën tjetër jo. Ky lloj agjërimi është më i fortë për ta shtypur nefsin. Shumë hadithe flasin për vlerat e këtij agjërimi, sepse duke agjëruar kështu, robi një ditë agjëron ndërsa ditën e dytë falënderon Allahun Teala.

⁴⁰ Imam Ahmedi dhe Nesei.

Resulallahu s.a.v.s., thotë:

“Më janë paraqitur çelësat e thesareve të kësaj bote dhe të Tokës. Të gjitha i kam refuzuar dhe kam thënë: *“Rri i uritur një ditë, ndërsa jam i ngopur ditën tjetër, Të Falënderoj kur jam i ngopur, ndërsa i penduar Të Lutem kur jam i uritur.”*”⁴¹

Resulallahu s.a.v.s., ka thënë edhe:

“Agjërimi më me vlerë është ai i vëllaut tim Davudit, a.s., i cili agjëronte një ditë dhe nuk agjëronte ditën tjetër.” ⁴²

Për këtë arsye Resulallahu, a.s., ka porositur Abdullah b. Amr-in me këtë lloj agjërimi, e kur Abdullahu i tha: *“Mundem dhe më shumë se kaq”* Resulallahu s.a.v.s., ia ktheu:

- Agjëro një ditë dhe pusho ditën tjetër.

⁴¹ Tirmidhiu nga Ebu Umame

⁴² Buhari dhe Muslimi nga Abdullah b. Amr.

Në atë, Abdullahu tha:

- *Dua diçka edhe më me vlerë se kjo, e*

Resulallahu s.a.v.s., u pergjigj:

- **Nuk ka më me vlerë se kjo.**⁴³

Transmetohet se:

Resulallahu s.a.v.s., nuk ka agjëruar asnjë muaj të plotë, përveç muajit të Ramazanit.⁴⁴

Kush nuk mund të agjërojë llojin e agjërimit të praktikuar nga Davudi, a.s., nuk është keq të agjërojë një të tretën e vitit, kjo nënkupton agjërimin një ditë dhe dy të tjera pasuese nuk agjëron. Nëse personi agjëron tri ditë në fillim, tri ditë në mes dhe tri ditë në fund të muajit edhe kjo do të thotë një e treta e vitit, në të njëjtën kohë llogaritet që ti ketë agjëruar edhe ditët e vlefshme.

⁴³ Buhari dhe Muslimi nga Abdullah b. Amr.

⁴⁴ Buhari dhe Muslimi, transmetuar nga Ajsha r.anha.

Nëse personi agjëron çdo të hënë, të enjte dhe të premte kjo është afër me një të tretën e vitit.

Deri tani nga shpegimet u kuptuan kohët e vlefshme të agjërimit.

Vërtetë është përkryerje të kuptohet domethënia e agjërimit, qëllimi i agjërimit i cili është pastrim i zemrës nga vesveset, dhe drejtimi kah Allahu Teala me tërë fuqinë e zemrës. Personi largpamës që kupton hakikatin, i njeh hollësitë e fshehta (*batin*) dhe arrin të vlerësojë gjendjen e vet. Nëse gjendja kërkon agjërim të vazhdueshëm apo mos-agjërimit të vazhdueshëm, ose ndonjëherë agjërim e ndonjëherë mos-agjërim, veprohet sipas saj.

Duke kuptuar domethënien e agjërimit pas përpjekjes së nevojshme, dhe duke hyrë në rrugë të ahiretit me kontrollimin e zemrës, personi duhet edhe më shumë të frikësohet nga rehatia e zemrës. Kjo nuk kërkon një rregull të vazhdueshëm.

Andaj transmetohet për Resulallahun,
s.a.v.s.:

“Ndonjëherë agjëronte aq gjatë, saqë thoshe se nuk do t’a ndërprejë agjërimin më, e ndonjëherë nuk agjëronte për një kohë të gjatë, aq sa thoshe se nuk do të agjëronte më. Kur ishte në gjumë, thoshe as nuk do të zgjohet në namaz të natës, e sa ishte në ibadet, thoshe nuk do të flejë.”⁴⁵

Këtë e praktikonte Resulallahu s.a.v.s., e si do të përshtatej në kohë të vlefshme, e zbulonte përmes nurit të nubuvvetit (drita e pejgamberllëkut).

Disa dijetarë e konsiderojnë të papëlqyeshme mos-agjërimin më gjatë se katër ditë, duke llogaritur si masë krahasuese katër ditët e Kurban Bajramit. Ngase më shumë se kjo (më shumë se katër ditë pa agjëruar) zemra bëhet edhe më e pandjeshme, lindin adete të papëlqyeshme dhe hapen dyert e epsheve. Sipas mendimit

⁴⁵ Buhari dhe Muslimi nga Ajsha r. Anha.

tim, kjo është e vërtetë tek shumica e njerëzve e në veçanti tek ata të cilët ushqehen dy herë: në mëngjes dhe në mbrëmje.

Këtë dëshironim t'a tregonim duke folur për agjërimin vullnetar (*nafile*). Vërtetë Allahu e di më së miri.

Me këtë përfundohet libri 'Fshehtësitë e agjërimit'. Falendërimi i takon vetëm Allahut Teala për mirësitë e shfaqura, dhe të fshehura.

Salavate dhe selame të shumta i qofshin zotërisë tonë Muhammedit, a.s., familjes dhe as'habëve të tij.

Me lejen e Allahut Teala pason libri 'Fshehtësitë e haxhit'. Allahu Teala është Ai i Cili ndihmon, Atij i besojmë dhe prej Tij kërkojmë ndihmë, Allahu është i mjaftueshem për ne, mbrojtës i mirë është Ai.